



CRPM

Qendra për hulumtim dhe krijim të politikave



PERSPEKTIVAT E GRAVE NË ZONAT RURALE

Analizë e shkurtër politikash nr. 20

Shkup
2012

(c) 2012 QHKP

Përmbledhja e shkurtër e "Perspektivës së grave në zonat rurale", paraqet gjetjet kryesore dhe rekomandimet e dala si rezultat i nje kërkimi të gjërë të kryer nga Qendra për Hulumtim dhe Krijim të Politikave.

Autorët e studimit: Marija Risteska, doktore shkencash; Goran Llazarevski; Ana Mickovska, Profesore e shkencave filozofike.

Kërkues: Frosina Ilievska, Riste Zmejkovski; Bashkim Bakiu; Mirlinda Bakiu.

Disenjoi: Metodija Andonov

Shtypur në: Datapons, Skopje

Fotografitë:

Ballina: Toni Kocev, Elena Koneska, Kire Maslov / arkiva e UN Women

Faqet 4, 6, 8, 10: Dhururar nga Daniele Pedretti, Oxfam, Itali

Faqet 14, 18: Kire Maslov / arkiva e UN Women

Faqja 16: Paula Jojart / arkiva e UN Women

Faqja 20: Toni Kocev / arkiva e UN Women

Ky studim është zhvilluar me mbështetjen e Entitetit të Kombeve të Bashkuara për Barazi Gjinore dhe Fuqizimin e Grave (UN Women); Agjenci e Kombeve të Bashkuara dedikuar barazisë gjinore dhe fuqizimit të grave. Për më shumë informacion për UN Women shikoni www.unwomen.org.

Mendimet dhe pikëpamjet e shprehura në këtë publikim janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë detyrimisht mendimet dhe pikëpamjet e UN Women, Kombeve të Bashkuara apo të organizatave të tjera të lidhura me to.

PERSPEKTIVAT E GRAVE NË ZONAT RURALE

PËRMBAJTJA

Parathënie	5
Përmbledhje e studimit	7
Hyrje	7
Rezultatet kryesore të studimit	9
Qasja ndaj mundësive pengohet nga mungesa e shërbimeve të nevojshme në zonat rurale	9
Fuqia transformuese e arsimit pengohet nga kapaciteti i kufizuar i tregut të punës	11
Përpjekje të mëtejshme nevoiten për të përmirësuar statusin shëndetësor në zonat rurale për të ngritur e vetëdijen dhe pavarësinë në shfrytëzimin e shërbimeve shëndetësore	12
Dominimi i stereotipeve gjinore dhe referencat socio-kulturore	13
Potenciali i bujqësisë të mos jetë vetëm strategji për mbijetesë	15
Përgjigjja institucionale ndaj nevojave të grave në zonat rurale	17
Aksione të kufizuara pozitive dhe pengesat institucionale që pengojnë zbatimin e tyre efektiv	19
Rekomandime për krijim të politikave	21
Rekomandime për pushtetin qendror	21
Rekomandime për pushtetin vendor	24
Rekomandime për partneritet më të mirë privato-publik dhe për të rritje të përfshirjes së shoqërisë civile	25
Informacione shtesë	26



PARATHËNIE

Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë ka arritur progres në përmirësimin e zbatimit të detyrimeve kombëtare ndaj barazisë gjinore. Respekti për të drejtat e grave si të drejta të njeriut dhe avancimi i barazisë gjinore janë parimet dhe qëllimet kryesore të qeverisë së Maqedonisë, të përcaktuara në kushtetutë dhe në ligjet specifike. U themeluan mekanizma për barazi gjinore në nivel qendror dhe vendor, u miratuan politika specifike dhe u përmirësuan kornizat ligjore përmes rishikimit bashkëkohor të Ligjit për mundësi të barabarta të grave dhe burrave. Duke njohur faktin që barazia dhe drejtësia shkojnë krah për krah me njëra-tjetrën, Plan i kombëtar i veprimit për barazi gjinore 2007-2012 parashikon që të punohet për "barazi gjinore dhe trajtimin e mosbarazisë ekzistuese shpesh herë do të thotë të punohet në mënyrë të ndryshme me burrat dhe gratë, të pranohet që gratë shpesh herë kanë nevojat dhe prioritetet të ndryshme, ato ballafaqohen me pengesa, kanë aspirata të ndryshme dhe kontribuojnë në mënyra të ndryshme për zhvillimin." Panvarësisht progresit të arritur në kornizat institucionale, politike dhe ligjore, dallimet gjinore dhe mosbarazitë vazhdojnë të ekzistojnë, e veçanërisht mes grupeve më të ndjeshme.

Në përpjekje për të siguruar ndihmë domethënëse teknike si mbështetje për zbatimin e prioritetëve kombëtarë, UN Women ka përkrahur kërkimin që kontribon në arritjen e njërit prej qëllimeve kryesore strategjike të Planit kombëtar për veprim për barazi gjinore: gjegjësisht, studimi aktual tenton që të sigurojë vlerësim gjithëpërfshirës të statusit të grave të zonave rurale në vend dhe të krahasojë atë me statusin e meshkujve të zonave rurale, si dhe kundrejt popullatës së zonave urbane me qëllim që të sigurohet një bazë e të dhënave për masat konkrete që shpien në emancipimin e grave rurale. Studimi bën analizë të kornizave ligjore dhe politike në fuqi, hulumton shkallën e përjashtimit social të grave në zonat rurale nga tregu i punës, nga jeta vendore publike dhe sociale, nga pjesëmarrja në proceset vendore vendimmarrëse, por gjithashtu përfshin edhe qëndrimet e tyre rreth nevojave dhe sfidave. Studimi identifikon dallimet, por edhe mundësitë që gratë e zonave rurale mund t'i kenë që të zgjidhin (dhe të sfidojnë) pengesat me të cilat ballafaqohen.

Rezultatet dhe konkluzionet e studimit inkurajojnë krijuesit e politikave që të vënë re disavantazhet dhe sfidat, por gjithashtu edhe të shohin përtej dhe të eksplorojnë mundësitë që gratë e zonave rurale zotërojnë për të përparuar personalisht dhe për të zhvilluar komunitetet ku jetojnë. Analiza ofron të dhëna të detajuara për nevojat dhe brengat e grave të zonave rurale dhe inkurajon krijuesit e politikave vendore dhe qendrore, si dhe personat vendimmarrës, që të shohin zhvillimin e komunitetit nga perspektiva e gruas rurale. Studimi fton për përshtatje të politikave vendore dhe kombëtareme realitetin të cilin e jetojnë gratë e zonave rurale me qëllim që të mënjanojnë barrierat me të cilat ballafaqohen çdo ditë. Në fund studimi potencon nevojën urgjente për t'u siguruar që gratë e zonave rurale janë pjesë e vendimmarrjeve kyçe.

Investimi i energjisë dhe resurseve në krijimin e një ambienti që ofron mbështetje për gratë e zonave rurale nuk do të thotë progres vetëm për gratë, por edhe për tërë komunitetin ku ato jetojnë. Siç ka theksuar Michelle Bachelet, drejtor ekzekutiv i UN Women dhe nën-sekretar i përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, imperativi për emancipimin e grave të zonave rurale është i qartë: "ne nuk mund më të lejojmë që të lëmë gratë mënjane... zërat e grave duhet të dëgjohen në procesin vendimmarrës në të gjitha nivelet nëse dëshirojmë të arrijmë paqe dhe demokraci afatgjate, dhe zhvillim të qëndrueshëm".

Erika Kvapilova
Drejtoresh e Programit Rajonal
Për Evropën Qendrore dhe Jug-Lindore, UN Women



1 "Në pajtim me Rezolutën 817 të Këshillit të sigurimit të Kombeve të Bashkuara, Kombet e Bashkuara në mënyrë provizore për çdo qëllim i referohet vendit si 'Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë'.



PËRMBLEDHJE E STUDIMIT

HYRJE

Gjatë viteve të shkuara, janë bërë përpjekjeve të mëdha në Maqedoni për të nxitur barazinë gjinore. Ngritja e mekanizmave për barazi gjinore në nivelin qendror dhe vendor, miratimi i kornizave ligjore mbështetëse ku bën pjesë edhe Ligji për Mundësi të Barabarta të Burrave dhe Grave i rishikuar jo shumë kohë më parë përbëjnë arritje të konsiderueshme. Mirëpo, ashtu si dhe në shumë vende në rajon, beteja kryesore vazhdon të zhvillohet në drejtim të zbatimit të kornizave normative në veprime pozitive dhe rezultate konkrete në jetën e grave, e veçanërisht për grupet më të ndjeshme dhe të përjashtuara të tyre.

Rekomandimet e Komitetit për Eliminim të Diskriminimit të Grave, të bëra në vitin 2006, kanë theksuar nevojën e grave që jetojnë në zonat rurale dhe të grave pjesëtare të pakicave etnike duke theksuar që ka patur vetëm përpjekje të kufizuara për të zgjidhur përjashtimin e tyre social. Probleme të ngjashme janë ritheksuar edhe në raportet e Bashkimit Evropian (BE) për progresin e vendit në rrugën drejt integritimit në BE.

Zgjidhja e tyre, duke përfshirë edhe sfidat komplekse fillon si dhe çdo rrugë tjetër e vështirë nga hapi i parë – ballafaqimi dhe të kuptuarit e çështjes në fjalë. Në vend mungonte një analizë gjithëpërfshirëse e gjendjes së grave rurale dhe arsyjeve të përjashtimit të tyre social. Për këtë arsye, qëllimi i projektit kërkues i këtij publikimi të prezantuar ishte sigurimi i një analize gjithëpërfshirëse që vlerëson situatën e grave në zonat rurale përmes të dhënave në dispozicion, për të identifikuar nevojat e tyre dhe sfidat me të cilat ballafaqohen, si dhe për të analizuar shkaqet e përjashtimit të tyre social. Kjo çoi në studimin në terren

të zonave rurale me qëllim që të plotësohen nevojat vazhdimisht në rritje për përfshirje të përvojave individuale të grave me qëllim për të kuptuar jetën rurale dhe mënyrën se si ajo ndikon në situatën e grave në shoqëri. Kërkimi në terren siguroi dëshmitë e nevojshme për mënyrën se si jeta në zonat rurale ndikon mbi gratë në mënyrë të ndryshme nga ajo që ndikon mbi jetën e burrave. Ky studim plotësoi mungesën e studimeve të mëparshme dhe të të dhënave të pjesshme zyrtare mbi gratë e zonave rurale. Kërkimi kishte për qëllim të sigurojë të dhëna sasiore dhe cilësore për formulimin e politikave që do të marrin në konsideratë nevojat specifike të grave të zonave rurale. Prandaj, ky studim ofron rekomandime të bazuara në analizat në terren, të krahasuara me rezultatet e analizave të kornizës ligjore dhe politikave publike që janë ngritur për të mbështetur (apo që nuk arrijnë të zgjidhin) përfshirjen dhe zhvillimin e grave në zonat rurale.



REZULTATET KRYESORE TË STUDIMIT

Analiza bazë për gratë e zonave rurale vërtetoi ekzistencën e një literaturë të kufizuar për to në Maqedoni. Në veçanti, kjo analizë përmes të dhënave në dispozicion dhe të rezultateve në terrendëshmoi përjashtimin e gjerë të grave të zonave rurale duke filluar nga tregu i punës, në jetën publike vendore dhe jetës sociale, e deri tek pjesëmarrja në proceset e vendimarrjes vendore që pozitivisht do të kishin ndikuar në zhvillimin e komunitetit ku ato jetojnë dhe do të sillnin ndryshime të dëshiruara në jetën e tyre.

QASJA NDAJ MUNDËSIVE PENGOHET NGA MUNGESA E SHËRBIMEVE TË NEVOJSHME NË ZONAT RURALE

Pjesa më e madhe e popullsisë rurale jeton kryesisht zonat e Pollogut, në rajonet jug-lindore dhe jug-perëndimore të Maqedonisë. Në këto rajone, popullata rurale po ballafaqohet me infrastrukturë të pazhvilluar dhe mundësi të kufizuara të shërbimeve publike. Këta faktorë, së bashku me vlerat tradicionale që dominojnë në zonat rurale i vendosin gratë e këtyre zonave në një pozitë të vështirë, duke kufizuar mundësinë e lëvizjes (ato nuk mund të shkojnë vetëm tek mjeku, nuk mund të dërgojnë fëmijët në kopshtin më të afërt, nuk mund të shkojnë në agjensi për punësim për të kërkuar punë, etj.) qasjen në informata dhe në mundësitë për zhvillim. Në lidhje me mundësinë e tyre për lëvizje, gratë e zonave rurale ballafaqohen me pengesa shtesë për shkak të stereotipeve gjinore dhe të mungesës së aftësive për të mbështetur lëvizjen individuale (p.sh. leja e drejtimit të automjetit). Kërkimi rekomandon që krijuesit e politikave të marrin parasysh aspektin gjinor gjatë përmirësimit të infrastrukturës, për shkak të përgjegjësisë të ndryshme tradicionale në zonat rurale për burrat dhe gratë si dhe prioritetet e ndryshme për sa i përket përmirësimit të infrastrukturës bazë.

FAKTE TË SHKURTRA ME KËNDVËSHTRIM GJINOR

Shërbimet e kufiziara publike pengojnë mundësitë e grave në përgjithësi duke përfshirë fuqizimin ekonomik.

FAKTE:

Në 90% të fshatrave të zonave malore dhe në 70% të fshatrave të zonave fushore, shërbimi për kujdesin ndaj fëmijëve nuk është në dispozicion dhe për të arritur në kopshtin më "të afërt" për fëmijë gruaja duhet të ecet 1 orë e 30 min. apo edhe më tepër në këmbë. Në fakt, fëmijët në shumë zona rurale rallë herë pranohen në qendrat për përkujdesje për fëmijë. Për shembull, përqindja më e ulët e fëmijëve të moshës 0-7 vjeç të pranuar në kopshte është në rajonin e Pollogut (2.5%) dhe në pjesën jug-perëndimore (6.5%). Mesatarja në nivel shtetëror e fëmijve që frekuentojnë kopshtet është 12%.

PERSPEKTIVA E SAJ:

"Nuk ka kush të kujdeset për fëmijët e mi, nuk ka kopësht në afërsi, prandaj nuk mund të kërkoj punë.



FUQIA TRANSFORMUESE E ARSIMIT PENGOHET NGA KAPACITETI I KUFIZUAR I TREGUT TË PUNËS

Pozita në disavantazh e grave të zonave rurale përforcohet nga shumë faktorë. Përveç mungesës së infrastrukturës dhe shërbimeve, gratë e zonave rurale balafaqohen edhe me nivel më të ulët arsimor në krahasim me gratë e zonave urbane dhe burrat e zonave rurale. Për shembull, ky studim tregon që gratë në zonat rurale mesatarisht kanë përfunduar vetëm arsimin fillor ndërsa gratë në zonat urbane mesatarisht kanë përfunduar arsimin e mesëm, përse i përket burrave në zonat rurale arsimit i tyre mesatarisht qëndron ndërmjet arsimit fillor dhe atij të mesëm. Mirëpo, studimi vëren një tendencë të të përmirësuar të arsimit të vajzave nga ai fillor në atë të mesëm. Por përsëri, dallimet gjinore në arsim edhe më tej përcaktohen në bazë të përkatësisë etnike/kulturore.

Ndërsa në grupin etnik maqedonas pritet që shumë shpejt të arrihet një barazi mes dy gjinive në arsim, në grupet etnike shqiptare dhe turke ka nevojë për mbështetje shtesë dhe ngritje të vetëdijes. Problemet me transportin e nxënësve nëpër shkolla duhet të zgjidhen sepse kjo mund të jetë një nga faktorët kryesorë që ndikon në nivel të ulët arsimor të vajzave nga zonat rurale. Në anën tjetër, rezultatet e studimit tregojnë që niveli i ulët i arsimit është i lidhur ngushtësisht me nivelin e mosaktivitetit ekonomik. Kryesisht, gratë e zonave rurale me nivel të ulët arsimor janë të vetëdijshme për numrin e vogël të vendeve të punës në dispozicion dhe shpeshherë vendosin të mos marrin pjesë në tregun e punës në krahasim me gratë që zgjedhin të kenë qëllime më ambicioze arsimore. Mirëpo, edhe pse gratë me nivel më të lartë arsimor, e veçanërisht ato me arsim universitar, kanë për qëllim të punësohen (siç dëshmon edhe niveli më i lartë i angazhimit të tyre), statistikat tregojnë që një numër i tyre akoma po lufton të hyjë në tregun e punës edhe pse përqindja e tyre e papunësisë është e lartë.

FAKTE TË SHKURTA ME KËNVËSHTRIM GJINOR

Gratë kanë nevojë për më tepër se shkollim për të hyrë në tregun e punës.

FAKTE:

23% e grave të zonave rurale nuk kanë ndjekur aspak ose kanë ndjekur vetëm pak nga shkollimi fillor. Njëkohësisht, niveli i mosangazhimit të tyre është i lartë (78%). Në anën tjetër, vetëm 5% e grave të zonave rurale kanë përfunduar arsimin e mesëm apo universitar. Megjithatë, edhe pse diploma universitare e zvogëlon përqindjen e mosangazhimit tek gratë e zonave rurale deri në pikën më të ulët (12%), përqindja e papunësisë tek ky grup mbetet shumë e lartë (40%), që do të thotë se mundësitë për punësim të grave të shkolluara nga zonat rurale janë të ralla dhe nuk përbëjnë nxitje që ato të qëndrojnë dhe të jetojnë atje.

NGA KËNDVËSHTRIMI I SAJ:

Për ne (gratë me arsim të lartë) nuk ka të ardhme në fshat. Të gjitha kërkojmë punë në qytet... por është shumë e vështirë të gjendet punë.

PËRPIEKJE TË MËTEJSHME NEVOITEN PËR TË PËRMIRËSUAR STATU- SIN SHËNDETËSOR NË ZONAT RURALE PËR TË NGRITUR E VETËDIJEN DHE PAVARËSINË NË SHFRYTËZIMIN E SHËRBIMEVE SHËNDETËSORE

Vështirësia më e madhe që ndeshin banorët e zonave rurale është qasja e kufizuar në shërbimet shëndetësore bazë. Megjithatë politika kombëtare shëndetësore është e ndjeshme ndaj nevojave të popullsisë së zonave rurale ndarja e mjekëve mbetet në mënyrë jo të barabartë nëpër zonat veçanërisht në zonat malore dhe në fshatrat më të largëta ku shërbimet janë edhe më të ralla. Prandaj, pritet që përmirësimi i kujdesit nga mjeku amë në zonat rurale të arrihet përmes përforsimit të mbikqyrjes dhe vlerësimit të funksionimit të mjekëve përgjegjës për të siguruar shërbime shëndetësore në zonat rurale. Qasja deri tek këto shërbime gjithashtu mund të përmirësohet përmes reformimit të ligjit për sigurim shëndetësor që do të mundësonte sigurimin shëndetësor individual (në vend të sigurimit të përbashkët me bashkëshortin/ bashkëshorten). Studimi ka vënë re që sigurimi i përbashkët shëndetësor përforcon edhe më tej varësinë e grave të zonave rurale nga bashkëshortët që mbajnë të drejtën për sigurim shëndetësor. Në fund, gratë e zonave rurale ballafaqohen me një sërë pengesash në qasjen e tyre deri tek shërbimet shëndetësore, e veçanërisht ato të specializuara e të vendosura në qendrat urbane, për shkak të shpenzimeve të larta (për shërbimet dhe transport), lëvizjes së kufizuar individuale (mungesa e aftësive dhe mjeteve – p.sh. drejtimi i automjetit, kufizime në transportin publik) dhe/ose normat kulturore (nevoja për të qenë e shoqëruar nga partneri mashkull, faktori i turpit) dhe pengesa e gjuhës (për disa gra pjesëtare të pakicave).

FAKTE TË SHKURTRA ME KËNDVËSHTRIM GJINOR

Për të pasur qasje në shërbimet shëndetësore, gratë duhet të përballen edhe me tabutë kulturore.

FAKTE:

Shërbimet e specializuara shëndetësore në 70% të fshatrave rurale janë më tepër se 1 orë e 30 minuta në këmbë larg vendbanimeve. Shumë gra të zonave rurale (mbi 52% të grave maqedonase, 43% të atyre shqiptare dhe 64% të grave turke) vizitojnë gjinekologun një herë në 5 vite, apo edhe më rallë, madje disa asnjëherë apo vetëm kur kanë nevojë. Përveç transportit dhe shpenzimeve për shërbimin, normat kulturore dhe traditat gjithashtu imponojnë pengesa, dhe vetëdija dhe gjuha luajnë role shtesë në këtë drejtim.

HER PERSPECTIVE:

Këtu ekziston turpi, edhe pse nuk duhet të jetë. Gratë shkojnë tek mjeku gjinekolog vetëm nëse kanë probleme dhe nuk shkojnë për kontrole të rregullta. Një numër i madh i grave nuk shkojnë për shkak se nuk janë të informuara. Ato turpërohen ... Edhe po të kishte mjek gjinekolog në fshat, ato nuk do të shkonin më shpesh për shkak se do t'u vinte turp që njerëzit t'i shohin atje. Të nesërmen do t'ju vijë turp të përshëndeten me njerëzit në rrugë.

DOMINIMI I STEREOTIPEVE GJINORE DHE REFERENCAT SOCIO-KULTURORE

Statistikat e aktivitetit/pasivitetit në tregun e punës tregojnë dallime të dukshme gjinore të cilat në pjesën më të madhe shikohen në pasivitetin e madh të grave rurale. Studimi tregon që shkalla e aktivitetit ekonomik është dy herë më e madhe te burrat (në zonat urbane dhe rurale) se sa te gratë rurale në të gjitha grup-moshat. Një tjetër gjetje e studimit është që gratë urbane nga 25 deri në 60 vjeç janë më aktivisht të përfshira në forcat e punës se sa gratë rurale. Një dallim i tillë nuk vihet re midis burrave nga zonat urbane dhe rurale.

Gratë rurale të cilat ballafaqohen me një jetë të vështirë, me mundësi të kufizuara të shërbimeve publike dhe jetë në varfëri, patjetër janë të gatshme të braktisin fshatrat, në rast se nuk u ofrohen mundësi të reja ekonomike, para së gjithash, mundësi punësimi. Gratë e reja të cilat jetojnë në mjedise rurale, sidomos kanë vështirësi të hyjnë në tregun e punës.

Studimi tregon se shkalla e papunësisë tek gratë e reja rurale, duke filluar nga mosha 20 vjeçare, ka tendencë negative në krahasim me femrat urbane të së njëjtës moshë. Arsyeja kryesore e kësaj tendence është roli tradicional që gruaja rurale duhet të luajë në familje (si bashkëshorte dhe nënë) dhe puna pa pagesë në shtëpi.

Ndryshime të rëndësishme etnike ekzistojnë gjithashtu në pasivitetin ekonomik të grave në zonat rurale. Studimi tregon se gati gjysma e grave rurale të komunitetit maqedonas që morën pjesë në studim fitojnë apo janë të pavarura. Njëzet e pesë përqind e grave rurale shqiptare dhe asnjë nga gratë turke që morën pjesë në studim nuk fitojnë asnjë të ardhur. Këto tendenca pabarazie vërtetojnë që roli parësor i grave në zonat rurale mbetet ajo e kujdesit për fëmijët ndërsa për burrat roli i tyre është të fitojnë para për të ushqyer familjen. Kjo traditë është më e pranishme në familjet dhe komunitetet muslimane. Masat aktive për tregun e punës nuk i kanë gratë rurale si grup të synuar i vecantë. Si të tilla, masat aktuale nuk arrijnë deri te gratë rurale të cilat janë jo aktive.

FAKTE TË SHKURTRA ME KËNDVËSHTRIM GJINOR

Gratë e reja kanë shumë vështirësi të futen në tregun e punës. Përgjegjësitë tradicionale me fokus në kujdesin ndaj familjes forcon arsyet pse pjesa më e madhe e tyre janë jo aktive gjatë periudhës së riprodhimit.

FAKTE:

3 nga 4 gra në zonat rurale janë të papuna. Gratë e reja nga zonat rurale të moshës prej 20-24 vjeç (59%) dhe 25-29 vjeç (43%) ballafaqohen me shkallën më të lartë të papunësisë.

Gjithësej 64% e grave në zonat rurale zyrtarisht janë ekonomikisht joaktive. Sipas kërkimit, shkaku më i shpeshtë për pasivitetin e tyre janë rritja e fëmijëve dhe punët në familje. (këtë shkak e kanë deklaruar 43% nga gratë jo aktive rurale). 47% e grave rurale të papuna megjithatë bëjnë një numër të madh aktivitete (p.sh. në fermat familjare, merren me zejtari ose kohë pas kohe punojnë për persona të tjerë), por puna e tyre në të shumtën e rasteve është e papaguar.

NGA KËNDVËSHTRIMI I SAJ:

Ne jemi amvise, nuk kërkojmë punë, njëkohësisht nuk ka punë as për burrat, ata janë të papunë, ndërsa ne kemi shumë punë në shtëpi: lajmë rrobet, bëjmë punët e shtëpisë...

Unë rri në shtëpi dhe bëj punët e shtëpisë, nuk punoj askund. Edhe ne gratë duhet të punojmë, por nuk kemi çfarë të punojmë, edhe në rast se gjejmë punë nuk besoj se burrat do të na lejojnë të punojmë.



POTENCIALI I BUJQËSISË TË MOS JETË VETËM STRATEGJI PËR MBIJETESË

Në zonat rurale, puna në bujqësi është parë si mënyrë për të përmirësuar cilësinë e jetës. Kjo punë është më pak e paguar dhe, sipas statistikave, në këtë sektor janë të regjistruar burrat si punëtorë ose në kompani bujqësore. Të dhënat statistike dhe kjo analizë dëshmojnë që gratë përbëjnë shumicën e punëtoreve të papaguara dhe të pa deklaruar si punëtore familjare apo si punëtore sezonale në bujqësi. Të paguara pak ose aspak në bujqësi sëbashku me mundësitë e kufizuara për të gjetur punë dhe me një numër shumë të madh papunësie situata e grave në zonat rurale i bën ato akoma dhe më të pa mbrojtura.

Studimi tregon që gratë e reja nga zonat rurale nuk janë më të interesuara të kalojnë të ardhmen e tyre duke u marrë me bujqësi dhe thonë që do të vazhdojnë të jetojnë në fshat vetëm nëse gjejnë punë jashtë fushës së bujqësisë.

Ka më tepër mundësi që gratë të braktisin fshatin për t'u shpërngulur në qytet për martesë. Një prej arsyeve se përse ato migrojnë më lehtë në krahasim me burrat e zonave rurale është sepse gratë nuk kanë pronë të tyre dhe nuk kanë çfarë të humbasin nëse e braktisin atë.

Një mënyrë për të rritur motivimin e grave në zonat rurale është të përfshihen në aktivitete biznesi bujqësor se sa të shikojnë për mundësi jashtë fushës së bujqësisë ose të migrojnë. Një mundësi tjetër është rritja e qasjes së grave në pronë duke përfshirë këtu tokën e punëshme dhe llojet të tjera të pronave.

Këto reforma gjithashtu mund të kontribuojë në suksesin e politikës për zhvillimin e zonave rurale nëpërmjet së cilës synohet nxitja e shumëllojshmërisë së aktiviteteve bujqësore si në turizëm rural, dhe aktivitete të tjera ekonomike.

Informacioni i pakët që kemi në dispozicion tregon nevojën për marrjen e masave për nxitjen e turizmit rural që të mbështesë gratë dhe të rinjtë të zbulojnë një ndikim pozitiv për të rritur numrin e grave që kanë dorëzuar kërkesa të suksesshme, edhe pse ato akoma janë më pak se numri i burrave parashtrues të kërkesave të suksesshme. Megjithatë, është e nevojshme një analizë shtesë e detajuar mbi ndikimin e këtyre masave.

FAKTE TË SHKURTRA ME KËNDVËSHTRIM GJINOR

Bujqësia shikohet si punë për burra. Tradicionalisht, prona familjare zotërohet nga burrat, gjë që grave u lë shumë pak hapësirë të dëshmojnë të kundërtën dhe kufizon ato në shfrytëzimin e mundësive.

FAKTE:

Vetëm 38% e të punësuarve në fushën e bujqësisë, gjuetisë dhe pylltarisë janë gra, përfshirë këtu edhe të punësuarit sezonale. Gratë fitojnë 33% më pak se burrat në këto sektorë. Shumë gra aktive nga zonat rurale (20%) punojnë në pronat e familjes pa qenë të paguara dhe shumë pak prej tyre janë dhe zyrtarisht të regjistruara si fermere. Shumica e grave nga zonat rurale (58%) nuk kanë të ardhura personale, ndërsa në më pak se 6% të familjeve ato janë pronare të shtëpive apo të tokës së tyre punuese. Në të kundërt, shumica e burrave, përveç të ardhurave personale, kanë kontroll edhe mbi pronën familjare – në rreth 80% të familjeve rurale, bashkëshorti apo babai i tij janë pronar të shtëpisë familjare, ndërsa në 62% të familjeve ata janë pronarë edhe të tokës punuese.

NGA KËNDVËSHTRIMI I SAJ:

Gjithçka që i takon vjerrit tim, i takon edhe bashkëshortit tim, ne jetojmë së bashku dhe pasuria është e jona. Nuk ka pasur nevojë që pronësia të kalojë tek gratë. Nëse një grua shkon në pikën e blerjes, do të qeshnin me të. Madje edhe nëse gruaja di më tepër se burri, atë mund ta thotë në shtëpi, jo në publik.



PËRGJIGJJA INSTITUCIONALE NDAJ NEVOJAVE TË GRAVE NË ZONAT RURALE

Kërkimi analizoi një numër të konsiderueshëm të institucioneve dhe politikave publike ekzistuese në Maqedoni në mënyrë që të shikonte mjedisin për mundësitë për procese reformuese për përmirësimin e standardit të jetës së grave rurale.

Këto reforma, përfshijnë fushat në vijim: reforma për përforcimin e barazisë gjinore (Ligji për Mundësi të Barabarta, Plani i veprimit Kombëtar për Barazi Gjinore, etj.) reforma që kanë për qëllim rritjen e numrit të të punësuarve (Masa Aktive për Punësim, Strategjia për Punësim, etj.), reforma për Mënjanim të Varfërisë (Strategjia për Zvogëlim të Varfërisë dhe për Përfshirje Sociale 2010-2020) dhe reforma për përmirësim të zhvillimit rural (Strategjia për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, Programi Kombëtar për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, programi IPARD, etj.). Megjithatë, nga gjithë këto korniza, dy prej tyre përmbajnë masa dhe objektiva specifike që kanë për synim gratë e zonave rurale: politika për zhvillim rural dhe plani kombëtar për barazi gjinore. Politikat tjera njohin problemet e grave të zonave rurale, por janë neutrale në lidhje me sigurimin e masave që do të ofronin zgjidhje të problemeve. Ajo që inkurajon më tepër në politikën për zhvillim rural është ajo që përfshin dy masa të ndjeshme ndaj çështjeve gjinore. Përmes tyre, nxiten gratë të aplikojnë për mbështetje institucionale me qëllim që të stimulohet angazhimi ekonomik i grave në bujqësi dhe në turizmin rural.

FAKTE TË SHKURTRAME KËNDVËSHTRIM GJINORE

Programet bujqësore janë të hapura për të gjitha gratë – parashtruese të kërkesave; megjithatë, burrat fermerë edhe më tej paraqiten si përfitues më të shpeshtë të ndihmës institucionale. Megjithatë, disa gra janë të interesuara të përparojnë në bujqësi.

FAKTE:

Disa prej burrave të zonave rurale (46) dhe grave (40) që janë identifikuar si fermerë gjatë zbatimit të kërimit, përfshirë edhe ata të peregjistruar – joformalë – shumica e fermereve gra (65%) asnjëherë nuk kanë paraqitur kërkesë për ndihmë institucionale dhe financiare për aktivitetet e tyre bujqësore, ndërsa 67% e burrave fermerë kanë paraqitur kërkesa. Arsyeja kryesore është mosplotësimi i kushteve që do t'i bënte ato të kualifikoheshin për të parashtruar kërkesën.

NGA KËNDVËSHTRIMI I SAJ:

Do të dëshiroja të vazhdoja shkollën ose të ndiqja ndonjë trajnim për fermerë, me siguri ekzistojnë shumë gjëra që nuk i di. Do të shkonim bashkë me bashkëshortin.



AKSIONE TË KUFIZUARA POZITIVE DHE PENGESAT INSTITUCIONALE QË PENGJOJNË ZBATIMIN E TYRE EFEKTIV

Duke u bazuar në të dhënat zyrtare në dispozicion, ky studim bën një vlerësim të shkurtër gjinor të aksioneve pozitive të përpiluara për të lehtësuar zhvillimin e zonave rurale dhe për të rritur mundësitë e barabarta. Studimi jo vetëm që ve në pah masat për përkrahje, por njëkohësisht kritikon mungesën e koordinimit institucional në kuadër të dokumenteve politike për çështje me rëndësi për gratë e zonave rurale. Në veçanti ky studim kritikon mungesën e përgjigjes jo të mjaftueshme për nevojat e grave rurale si dhe efikasitetin jo të mjaftueshëm të tyre për të zgjidhur problemet dhe faktorët që në mënyrë negative ndikojnë në jetën e tyre. Kjo kryesisht në të shumtën e rasteve sepse gratë e zonave rurale nuk marrin pjesë në marrjen e vendimeve, dhe nuk ekzistojnë njohuri që do të reflektonin nevojat e tyre dhe do të informonin politikë bërësit. Krahës kësaj, krijimi efektiv i politikave vështirësohet edhe nga mungesa e të dhënave, përfshirë krahasimet urbane/rurale, moshën dhe përkatësinë etnike me të dhënat gjinore. Për këtë arsye është vështirë edhe analiza gjinore thelbësore në shumë disiplina. Studimi më tej identifikon dy pengesa konkrete për zbatimin e politikave që përkrahin barazinë gjinore: (i) financimi jo i mjaftueshëm dhe jo i qëndrueshëm; dhe (ii) mungesa e një sistemi monitorues dhe vlerësues të efektshmërisë së politikave në veçanti ndikimi i tyre në jetën e grave të zonave rurale.

FAKTE TË SHKURTRA ME KËNDVËSHTRIM GJINOR

Gratë e zonave rurale rrallë herë konsultohen për çështje publike. Madje edhe kur marrin pjesë në aktivitete publike, ato nuk kanë besim në zhvillimin e procesit.

FAKTE:

Momentalisht nuk ka asnjë grua në detyrën e kryetarit të komunës. Edhe pse shumica e grave marrin pjesë në zgjedhje si votuese, vetëm 3% e tyre në zonat rurale do të përfshiheshin në jetën aktive politike (aktive në parti politike) dhe 2% do të merrnin pjesë në tribuna, debate apo në mbledhje publike në komunë. 72% e grave të zonave rurale që nuk marrin pjesë, nuk besojnë që do të kishin ndonjë përfitim nga kjo pjesëmarrje.

NGA KËNDVËSHTRIMI I SAJ:

Ata nuk organizojnë asgjë... I mbledhin fshatarët vetëm para zgjedhjeve dhe parashtojnë pyetje, dhe përsëri nuk ka asgjë për ne, gratë tona rrinë në shtëpi apo në fusha duke punuar. Çfarëdo që të themi, asgjë nuk do të merret parasysh. Shkojmë atje, ata flasin, ne dëgjojmë dhe kur përfundojnë, shkojmë në shtëpi. Nuk na pyesin për mendim dhe shpesh herë nuk mund të marrësh as fjalën.



REKOMANDIME PËR KRIJIM TË POLITIKAVE

Ky studim trajton mungesën e analizave gjinore aktuale për nevojat e grave në zonat rurale si dhe identifikimin e nevojave përmes analizave krahasuese të të dhënave. Ai prezanton analizën e politikave aktuale që ndikojnë në jetën e grave rurale si dhe në vlerësimin e kapaciteteve institucionale për zbatimin me efikasitet të këtyre politikave. Më në fund, studimi jep rekomandime për të mbështetur politikëbërjen për të rritur efektshmërinë e masave që mund të ndikojnë pozitivisht kushtet dhe mundësitë e grave në zonat rurale. Këto rekomandime kanë për qëllim të ofrojnë ndërhyrjet e nevojshme në axhendat politike të ministrive në Qeveri dhe në njësitë e vetqeverisjes vendore. Këto rekomandime nuk janë prezantuar si zgjidhje të gatshme, ato duhet të konsiderohen si fillimi për diskutimin e politikave që do të rezultojnë në zgjidhje për përmirësimin e jetës së grave në zonat rurale.

REKOMANDIME PËR PUSHTETIN QËNDROR

Politikëbërja dhe zbatimi i saj ka nevojë të jetë më e përgjegjshme për nevojat e grave në zonat rurale në mënyrë që të jetë efektive.

Sigurimi i të dhënave për nevojat e popullsisë rurale është me rëndësi thelbësore për zhvillimin e politikave të ndjeshme për gratë e zonave rurale dhe në përgjithësi për zhvillimin rural. Për këtë arsye, pushteti qendror duhet së pari të kujdeset për ngritjen e sistemeve për mbledhjen e të dhënave dhe përpunimin e tyre me sigurimin e shërbimeve publike si dhe ti bëjë ato të jenë të disponueshme për publikun me qëllim që të sigurohet krahasim i kategorive kryesore – gjini, seks, moshë, vendbanim urban/rural, përkatësi etnike; me të dhëna të ndara sipas gjinisë me të cilat do të mundësohet analiza gjinore e besueshme mbi të cilën do të mund të zhvillohen masa të përshtatshme (gjinore) që do të kishin për qëllim tejkalimin e dallimeve të identifikuara gjinore dhe që gjithashtu do të mund të rezultojnë me avancimin e barazisë gjinore. Një gjë e tillë mund të arrihet vetëm nëse ligjet bëhen të ndjeshme ndaj çështjeve gjinore dhe nëse ndërtohen mekanizma të duhur institucionalë për zbatim të tyre. Përfundimi i pozitës së grave të zonave rurale mund të arrihet edhe përmes përfshirjes së tyre më aktive në proceset këshilluese që do të ndihmonin që nevojat e tyre të dëgjohen dhe të reflektohen në mënyrë të duhur në procesin e krijimit të politikave.

PËRMBLEDHJE E SHKURTËR E REKOMANDIMEVE:

- Sigurimin e ngritjes së sistemeve për të mbledhur dhe analizuar të dhëna për shërbimet publike sociale të ofruara. Këto të dhëna duhet të jenë të arritshme për publikun dhe të mund të bëhet krahasimi i kategorive kryesore si moshë, gjinia, seks, përkatësia etnike, vendbanimi urban/rural.
- Sigurimin e analizës gjinore të të dhënave në hartimin e politikave, zbatimin e tyre, në monitorim dhe vlerësimin e rezultatit dhe ndikimit të politikës.
- Për të siguruar që proceset politikëbërëse përfshijnë masa konsultative që mundësojnë dhe inkurajojnë pjesëmarrjen aktive të grave në zonat rurale.

Për t'u përfunduar efikasiteti i politikave dhe ndikimi i tyre mbi përmirësimin e standardit jetësor të grave të zonave rurale, duhet të planifikohen dhe të sigurohen burime të përshtatshme për zbatimin e të gjitha prioritetëve relevante dhe të gjitha masave politike. Efektet e zbatimit duhet të monitorohen, ndërsa ndikimi të vlerësohet nga aspekti gjinor, duke përfshirë këtu edhe perspektivat e grave të zonave rurale.

Rritja e efektivitetit dhe ndikimi i programeve për zhvillimin rural për gratë

Zbatimi i analizës së detajuar gjinore, përfshirë analizën gjinore e buxhetore të programeve për zhvillim rural do të ketë rëndësi të madhe për ndihmën e aktiviteteve ekzistuese për promovim të nevojave të popullatës rurale përmes masave të politikës publike. Analiza e tillë duhet të përfshijë masat e ndjeshme ndaj gjinive dhe masat për afirmim për përforsim të pozitës së grave në zhvillimin rural dhe bujqësor me qëllim që rezultatet pozitive të jenë të qëndrueshme dhe të përfshira në politikat që mbulojnë çështjet gjinore në fushat tjera.

Që politikat e lartpërmendura të ndikojnë në përmirësimin e standardit jetësor të grave të zonave rurale, bujqësia duhet të bëhet aktivitet më atraktiv ekonomik për gratë, edhe atë përmes: njohjes së punës së papaguar, sigurimit të pagës së njëjtë dhe mënjanim të dallimeve në paga; përmirësimit të qasjes (siç janë të drejtat për pronësi) deri tek toka dhe mjetet bujqësore, promovimit të grave fermere si shembull prej të cilit duhet të mësojnë gratë tjera; zvogëlimi i shpenzimeve për fermerët e regjistruar, duke pasur parasysh karakterin sezonal të këtij lloji pune; zbatimin dhe përforsimin e më tepër përpjekjeve për ngritje të vetëdijes dhe për promovim të iniciativave në lidhje me instrumentet financiare për ndihmë të fermerëve, duke synuar në veçanti gratë e zonave rurale dhe gratë fermere; ngritja e vetëdijes tek gratë e zonave rurale për të drejtat për pronë (mbi tokën punuese) dhe sigurimi i ndihmës për realizim të të drejtave të tyre me qëllim që të mund të përmirësojnë pavarësinë tyre ekonomike dhe statusin si kandidatë të kualifikuar për subvencione bujqësore.

Investime më të mëdha nevojiten me qëllim matjen e rritjes së pjesëmarrjes së grave në zonat rurale në skemat aktuale bujqësore. Kjo përfshin investimet në masat e mëposhtme (i) inisjativa për rritjen e ndërgjegjesimit dhe përdorimin e kuotave për të inkurajuar gratë e zonave rurale të marrin pjesë në kurset e trajnimit për produkte të reja si bujqësia organike (ii) masa të cilat do të nxisnin edhe mbështesnin vetë punësimin në zonat rurale duke ulur kostot dhe dhënë kredi me interes të ulët në mbështetjen e grave për të filluar biznesin e tyre; (iii) masa për mbështetje teknike dhe rritjen e ndërgjegjes për të përgatitur aplikimet për mbështetje nga asistenca e ofruar nga IPARD.

PËRMBLEDHJE E SHKURTËR E REKOMANDIMEVE:

- *Për të përmirësuar efektivitetin dhe qëndrueshmërinë e politikave si dhe për të rritur përgjigjen ndaj nevojave të grave në zonat rurale është e nevojshme të integrohet në thellësi analiza gjinore në hartimin e politikave, duke përfshirë analizën gjinore të buxhetit të programeve për zhvillimin rural edhe marrjen e masave nxitëse me qëllim rritjen e pjesëmarrjes së grave në keto programe.*
- *Mbështetja e grave në zonat rurale si modele positive për kontributin që kanë dhënë në zhvillimin rural edhe buqësor dhe për të siguruar që gratë marrin pjesë në mënyrë të barabartë në ndarjen e pasurisë edhe përfitojnë prej saj. Paga e barabartë dhe pjesëmarrja e njëjtë në pasuritë publike.*
- *Të mbështeten gratë në zonat rurale duke përmirësuar mundësinë e pjesëmarrjes në skemat aktuale dhe duke siguruar që gratë përfitojnë nga këto mundësi njesoj si burrat kjo mbështetje duhet të sigurojë masa që do të përmirësojnë pjesëmarrjen e grave në informacion, përdorimin e kuotave ose sigurimin e minimumit të pragut në inisjativat e ndërtimit institucional si psh në trajnimet për buqësinë, masa që do t'ju jepnin grave më shumë mundësi.*

Rritja e mundësive për punësim të grave rurale

Mundësitë për punësim të grave rurale duhet të përmirësohen përmes përkrahjes së iniciativave që nxisin vetëdijen e grave të zonave rurale (përfshirë gratë e pakicave etnike) për përparësitë dhe ndihmën që ofrojnë masat aktive për punësim; iniciativat për ndërtimin e kapaciteteve për të lehtësuar qasjen e grave rurale (përfshirë gratë e pakicave etnike) që të shfrytëzojnë mundësitë në dispozicion për përfundim ekonomik; përmes ndryshimit dhe përshtatjes së programeve për punësim në kuadër të masave aktive për punësim (përmes kriterëve dhe masave të reja) me qëllim që të sigurohet përfshirja e grave joaktive të zonave rurale me kualifikim të ulët me qëllim që të nxitet dhe rritet aktiviteti i tyre ekonomik. Rishikimi i politikave duhet të reflektojë vlerësimin e kapaciteteve dhe dallimin gjinor me të cilin ballafaqohen gratë në tregun e punës dhe të mundësohet që gratë e zonave rurale me arsim ta pamjaftueshëm të kenë qasje deri tek programet për trajnim të personave të rritur (mësimi i përjetshëm) me qëllim që t'u afrohen mundësive për punësim. Kjo mund të përfshijë mundësi për përfundim të shkollimit fillor dhe të mesëm apo përmirësim të kapaciteteve për njohje të punës me kompjuter dhe përdorimit të internetit, aftësi për të kërkuar punë dhe për vetëpunësim.

Rishikimi i politikave duhet të marrë në konsideratë vlerësimin e kapaciteteve të grave rurale dhe mungesat e identifikuar në lidhje me nevojën e tregut për punë. Në veçant, është e rëndësishme që rishikimi i politikave të sigurojë qasjen e grave në zonat rurale me nivel të ulët shkollimi në pranimin e tyre në trajnimet për të rritur, programet specifike të hartuara sipas nevojave dhe mundësive. Këto trajnime mund të përfshijnë mundësitë e grave në zonat rurale për të përfunduar shkollimin fillor dhe të mesëm, të rrisin njohuritë e tyre në kompjuter dhe përdorim interneti, trajnime për njohuri për biznes dhe kurse për të rritur njohuritë e grave për të kërkuar punë ose për tu vetëpunësuar. Duhet të nxitet nisma për të krijuar rrjete të reja midis grave në zonat rurale duke përdorur mediat sociale edhe duke ndërtuar ura lidhjeje midis gjeneratave të ndryshme të grave.

Duke marrë parasysh vështirimin dominues që gratë e vendeve rurale do të donin punësim formal jashtë sektorit bujqësor, autoritetet duhet të përkrahin aktivitete ekonomike të grave të zonave rurale jashtë bujqësisë (p.sh. në turizëm vendor dhe shërbime që lidhen me të) si dhe iniciativa që nxisin apo lehtësojnë

PËRMBLEDHJE E SHKURTËR E REKOMANDIMEVE:

- *Të sigurohet që gratë janë mirë të informuara për përparësitë dhe ndihmën që ofrojnë instrumentet financiare (përfshi masat aktive për punësim) dhe t'u ofrohen mundësi për nxitje që të braktisin gjendjen e pasivitetit.*
- *Të sigurohet që nevojat dhe perspektivat e grave janë marrë parasysh dhe janë të njohura gjatë rishqyrtimit dhe adaptimit të politikave për punësim dhe për zhvillim ekonomik.*
- *Të sigurohet që vlerësimi i kapaciteteve (mangësitë dhe nevojat kundrejt mundësive të tregut të punës) shfrytëzohen për zhvillimin e iniciativave konkrete që kanë për qëllim gratë e zonave rurale (për shembull përmes programeve për trajnim të personave madhorë për gratë me arsim të ulët që përfundojnë arsimin fillor apo të mesëm, aftësitë për përdorim kompjuteri, aftësi për vetëpunësim dhe kërkim të vendeve të punës, etj.).*
- *Të përkrahen investimet për zhvillim ekonomik që sigurojnë mundësi jashtë fushës së bujqësisë dhe që mund të shfrytëzojnë aftësitë dhe kapacitetet e grave rurale (përfshirë lehtësimin e krijimit të rrjetit që do të krijojë mundësinë e lidhjes së bizneseve me profesionet/aftësitë që ofrojnë gratë rurale).*

krijimin e rrjetit të grave me aftësi konkrete si psh rrobaqepset, artizanet, etj të cilat zyrtarisht nuk janë njohur dhe bizneset që kanë nevojë për këto aftësi apo janë të përfshira në marketing të produkteve të bazuara në aftësi konkrete nuk i njohin. Përveç kësaj, janë të nevojshme politika (p.sh. nxitje tatimore) që do të përkrahin mënyra më të përshtatshme për punësim dhe punë të pjesshme që do të inkurajonte gratë të bëhen ekonomisht më aktive dhe të zgjidhin problemet e përkujdesjes për fëmijët dhe punët e tjera të shtëpisë.

REKOMANDIME PËR PUSHTETIN VENDOR

Përforcimi i proceseve pjesëmarrëse në krijimin e politikave

Pushteti lokal duhet të sigurohet që perspektivat e grave të zonave rurale janë të integruara në mënyrën e duhur në projektet për përmirësimin e infrastrukturës (p.sh. ujësjellësi, kanalizimet, rrugët, etj.) si dhe krijimi dhe sigurimi i shërbimeve publike.

Me qëllim që të njihen perspektivat e grave të zonave rurale, është e nevojshme që të rritet pjesëmarrja e tyre në proceset për krijimin e politikave, përfshirë krijimin, planifikimin si dhe zbatimin – duke përfshirë edhe monitorimin dhe vlerësimin e efektshmërisë së tyre. Përmes zbatimit të buxhetimit me pjesëmarrje dhe përdorimit të mjeteve për përpilimin e buxheteve të ndjeshëm ndaj çështjeve gjinore me qëllim sigurimin e përgjegjësisë së pushtetit lokal para popullatës rurale, e në veçanti ndaj grave të zonave rurale.

Përmirësimi i kapaciteteve dhe qasjes deri tek shërbimet publike

Autoritetet vendore në bashkëpunim me organet qendrore duhet gjithashtu të përmirësojnë kapacitetet e organeve ofruese të shërbimeve publike në nivel vendor për zgjerim të qasjes tek shërbimet për gratë dhe burrat e zonave rurale, për shembull përmes vizitave më të shpeshta në terren, gjë që duhet mbështetur përmes burimeve të duhura. Kjo padyshim që do të përmirësojë qasjen deri tek shërbimet publike, përfshirë: (i) transportin: duhet të përmirësohet shpeshtësia e shërbimit, sigurisë dhe terrenit të mbuluar; (ii) sigurim i rrjetit për përkujdesje të fëmijëve në zonat rurale që do të mundësojë gratë të kërkojnë punë në nivel vendor (përmes nxitjes së ofrimit publik apo privat të shërbimeve të këtij lloji ose përmes ndërmarrjes së aktiviteteve të njësitë e vet-qeverisjes vendore për kërkim të mundësive për grante qendrore të dhëna për zgjidhje alternative për sigurim të shërbimeve për përkujdesje të fëmijëve në zonat rurale); (iii) zbatimi dhe promovimi i programeve për shkollim falas për persona të rritur (shkollim fillor dhe të mesëm) që nuk kanë përfunduar shkollimin formal; (iv) kërkim të mundësive për vizitë të rregullt

PËRMBLEDHJE E SHKURTËR E REKOMANDIMEVE:

- Të institucionalizohen mekanizmat për pjesëmarrje të qytetarëve në krijimin e politikave në nivel vendor dhe të nxisin pjesëmarrjen e grave rurale dhe mundësojnë që nevojat dhe perspektivat e tyre të merren parasysh gjatë krijimit të politikave dhe planifikimit të zhvillimit rural.
- Përdorimi i buxhetit pjesëmarrës dhe mjeteve për përpilim të buxhetit duke marr parasysh aspektin gjinor me qëllim përmirësimi i plotësimit të nevojave të grave dhe burrave ruralë nga pushteti vendor.
- Të sigurohet që ofruesit e shërbimeve publike të kenë kapacitete për zgjerim të qasjeve deri te shërbimet e tyre për gratë në zonat rurale.
- Të sigurohet se janë vendosur shërbime për përkrahje, të cilat përqëndrohen në nevojat e grave rurale, përfshirë edhe përmirësimin e qasjes deri te transportit publik, sigurimin e shërbimit për përkujdesjen e fëmijëve, përmirësimin e shërbimit shëndetësor në zonat rurale, zbatimin e programeve arsimore për të rritur, etj.

nëpër fshatra nga ana e një mjeku pediatër dhe një gjinekolog të paktën një herë në javë; (v) kërkim të mundësive (p.sh. ndërmjetësues apo përkrahje për angazhim të personelit që njeh më tepër gjuhë) për të siguruar shërbime shëndetësore për pacientët e zonave rurale në gjuhët e tyre amtare, gjë që do të sillte përmirësimin e shërbimit shëndetësor për pjesëtarët e pakicave etnike.

REKOMANDIME PËR PARTNERITET MË TË MIRË PRIVATO-PUBLIK DHE PËR RITJE TË PËRFSHIRJES SË SHOQËRISË CIVILE

Autoritetet publike dhe subjektet private, përfshirë edhe organizatat qytetare, duhet të rrisin bashkëpunimin e tyre në mënyrë që të adresojnë në sfidat me të cilat përballen gratë e zonave rurale dhe të mund t'ju përgjigjen në mënyrë efektive nevojave dhe prioriteteve të tyre. Këtu mund të bëjnë pjesë partneritete për nisma të shumëllojshme midis organizatave të shoqërisë civile edhe institucioneve private ne vecanti me organizatat e grave edhe mbrojtësit e barazisë gjinore.

Bashkëpunimi më i madh edhe foricimi i parneriterit do të sillte përfitime për aktivitetet në vijim si për shembull: (i) fillimi i iniciativave për të thyer stereotipet tradicionale gjinore dhe barrierat e tjera që pengojnë gratë për të qënë të pavarura për të përdorur mjetet e transport publik edhe privat, përfshirë këtu mbështetjen e interesave të grave për t'u pajisur me leje për drejtim automjetit(ii) promovim aktiv i shembujve pozitivë të burrave të cilët do të shërbenin si model për shembull inkurajimin e burrave për të marrë lejen prindërore edhe ndarë përgjegjësitë e kujdesit për fëmijët në mënyrë më të barabartë (iii) ndertimii mekanizmave për te siguruar indentifikimin e hershëm të familjeve për të cilat ka rrezik se nuk do të regjistrojnë fëmijët e tyre në shkollë ose do t'i çregjistrojnë ata nga shkolla (për shembull familjet tradicionale myslimane ose familjet që jetojnë në vise të largëta malore), (iv) Këto mekanizma duhet të përfshijnë edhe promovimin aktiv të nderhyrjeve si : Ngritjen e vetëdijes dhe këshillimit të prindërve në fazat e hershme të shkollimit të fëmijëve të tyre.

Nxjtja e partneriteteve duke përfshirë mediat, ofruesit e shërbimit shëndetësor publik dhe privat, udhëheqësit vendorë dhe organizatat e shoqërisë civile duhet të përfshihen në iniciativat për ngritjen e vetëdijes në fushën e shëndetësisë, veçanërisht në promovimet për kontrolle të rregullta gjinekologjike (veçanërisht në komunitetet shqiptare dhe turke). Bashkëpunimi dhe përfshirja e ofruesve të shërbimeve parësore shëndetësore dhe doktoëve të specializuar

RECOMMENDED ACTIONS IN BRIEF:

- Të përkrahet partneriteti mes autoriteteve publike dhe sektorit privat, përfshirë shoqërinë civile dhe organizatat e grave që të jenë fuqi lëvizëse për iniciativa që do të plotësojnë nevojat e grave të zonave rurale.
- Të përdoren qasje më të gjera drejt partneriteteve (përfshirë autoritetet publike, shoqërinë civile, si dhe mediat, udhëheqësit fetarë dhe të komuniteteve, personat profesionistë, etj) për të ngritur vetëdijen dhe për të zgjidhur dhe sfiduar stereotipet gjinore që ndalojnë gratë rurale që të jenë aktive në jetën publike dhe të përfitojnë nga mundësitë ekonomike.
- Promovimi i bashkëpunimit dhe iniciativave të përbashkëta të partnerëve të shumëfishtë në nivel vendor për të zgjidhur çështjet që synojnë gratë e zonave rurale, përfshirë programet shëndetësore, përkrahje për procesin e shkollimit, apo promovimin e përgjegjësisë të barabarta mes burrave dhe grave në përkujdesjen e fëmijëve, etj.

është veçanërisht e nevojshme në inisjativar për parandalimin e sëmundjeve edhe duhet të përfshijë konsultime informative me komunitete vendore duke përfshirë mjekët si burime infomacioni.

Krahas kësaj, është thelbësore rritja e ndërgjegjësimit të burrave në zonat rurale për rëndësinë e parandalimit të sëmundjeve dhe inkurajimin e përfshirjes së tyre aktive përnxitjen e grave për kontrollet parandaluese në lidhje me shëndetin riprodhues të tyre . Të gjitha palët e synuara duhet të eksplorojnë së bashku mundësitë për të identifikuar masat e mundshme që do të përkrahnin kontrollet e detyrueshme gjinekologjike, ose/dhe zvogëlimin e shpenzimeve përmes mundësitë të kontrolleve falas për sëmundjet e pashërueshme (për shembull llojet e ndryshme të kancerit).

INFORMACIONE SHITESË:

Metodologjia e kërkimit përfshiu anketa për burrat dhe gratë nga zonat rurale dhe u zhvillua në pranverën e vitit 2011 në zonat rurale të Maqedonisë; diskutime të fokusuara me grupin e synuar u zhvilluan me gratë dhe burrat nga zonat rurale ndërsa me krijuesit e politikave u realizuan intervista individuale. Të dhënat e grumbulluara paraprakisht u analizuan me statistikat zyrtare, të dhëna nga burime dytësore (siç janë institucionet e lartpërmendura) dhe rishikim të ligjeve, vendimeve dhe rregulloreve, raporteve vjetore nga organe publike dhe raporte nga organizata ndërkombëtare, si dhe nga shoqëria civile. E fundit, dhe jo më pak e rëndësishme, është ajo që ekipi zhvilloi analizë gjinore të kornizave të ndryshme të politikave që kanë të bëjnë ose jo me realitete specifike në të cilat jetojnë gratë rurale që të mundësohet përpunimi i rekomandimeve relevante për politikën, edhe atë në mënyrë që do të transformojnë shoqëritë rurale dhe do të avancojnë standartin jetësor të grave të zonave rurale.

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

342.722-055.2:316.334.55(497.7)

RISTESKA, Marija

Perspektivat e grave në zonat rurale: analizë e shkurtër politikash nr. 20 /
[autorët e studimit Marija Risteska, Goran Lazarevski, Ana Mickovska;
kërkues Frosina Ilievska ... и др.]. - Shkup:
Qendra për hulumtim dhe krijim të politikave, 2012. - 25 стр. :
илустр. ; 21 см

ISBN 978-608-4586-27-2

1. Lazarevski, Goran [автор] 2. Mickovska, Ana [автор]

а) Жени - Родова еднаквост - Рурални средини - Македонија

COBISS.MK-ID 91440650

PERSPEKTIVAT E GRAVE NË ZONAT RURALE



Qendra për
Hulumtim dhe
Krijim
Politike

Cico Popovic 6-2/9
1000 Shkup, Maqedoni
crpm@crpm.org.mk
www.crpm.org.mk
www.facebook.com/crpm.org.mk